



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



SHËRBIMI I PROVËS

Nr. 954 prot., datë 03.07.2025



Nr. 49 prot., datë 03.07.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS

dhe

KONFERENCËS IPESHKVORE TË SHQIPËRISË

Sot më datë 03 / 07 / 2025, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve, si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, me adresë: Rruga “Jordan Misja”, Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi Postar 1016, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm (në mungesë), Drejtori i Mbikqyrjes Elektronike **Z. Eris SHESHI**, këtu e në vijim “Shërbimi i Provës”,

dhe

Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë, person juridik, i pavarur, me adresë: Rruga “Don Bosko”, 1001, Tiranë, e përfaqësuar nga Presidenti dhe Ipeshkëvi i Rrëshenit **Mons. Gjergj META**.

DUKE MARRË NË KONSIDERATË:

- Qëllimin e përbashkët për riaftësimin dhe riintegrimin e personave nën mbikëqyrje me dënimin alternativ “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik”;
- Nevojën për një bashkëpunim ndërinstitucional që do të sjellë një kontribut më efektiv në këto fusha;

DUKE JU REFERUAR:

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 10, pikat 4 dhe 5 i cili parashikon se shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve dhe marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave, e cila ratifikohet në Kuvend, si dhe nenit 24 të Kushtetutës që garanton lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë;
- Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nenit 9 të saj që garanton lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe të fesë;
- Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar”;
- Të Drejtës Kanonike (Kodit Ligjor të Kishës Katolike), e vendosur nga Kisha Katolike;
- Ligjit nr. 9365, datë 31.3.2005 “Për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të kishës katolike”;
- Ligjin nr. 78/2020, datë 25.06.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës” të ndryshuar me ligjin nr. 90/2024;
- VKM nr. 421, datë 08.07.2021 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës”.

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi (në vijim referuar “Marrëveshja”), si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1. *“Punë në interes publik”* sipas kësaj marrëveshje do të konsiderohet puna e përkufizuar sipas nenit 63 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
2. *“Dënime alternative”* janë alternativat e dënimit me burgim që mund të vendosen nga gjykata sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
3. *“Mbikëqyrje”* janë aktivitetet që kryhen nga Shërbimi i Provës për zbatimin e masave alternative dhe dënimeve alternative, si dhe urdhërimeve të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta me qëllim mbështetjen, këshillimin dhe riintegrimin në shoqëri të personit nën mbikëqyrje.
4. *“Person nën mbikëqyrje”* është i dënuari ndaj të cilit gjykata me vendim gjyqësor ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.
5. *“Specialist i Shërbimit të Provës”* është punonjësi i ngarkuar për mbikëqyrjen dhe asistimin e personit nën mbikëqyrje gjatë zbatimit të alternativave të dënimit me burgim në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. *“Shërbimi i Provës”* është organi shtetëror, përgjegjës për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe urdhërimeve të prokurorit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, të masave të shmangies nga ndjekja penale, të dënimeve jo me burgim për të miturit ose veprimtarive të tjera sipas akteve të tjera ligjore si dhe trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit nën mbikëqyrje për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri.
7. *“KISH”* është shkurtimi për Konferencën Ipeshkvore të Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim vendosjen e një bashkëpunimi të ndërsjelltë ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë për zbatimin e nenit 63 të Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik” pranë Kishës Katolike me qëllim riintegrimin dhe riaftësimin e personave të dënuar sipas nenit 63 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë të cilët pranojnë vullnetarisht kryerjen e punës në interes publik në zbatim të vendimit përkatës të gjykatës si një formë riparuese ndaj dëmit të shkaktuar nga kryerja e veprës penale.
2. Përcaktimet e kësaj marrëveshje nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore mbi bazë dhe në zbatim të të cilëve lidhet, por t’u ofrojë personave nën mbikëqyrje një mundësi të re zgjedhjeje për kryerjen e punës në interes publik nëpërmjet “KISH”.

Neni 3

Llojet e punës në interes publik

Kryerja e punës në interes publik do të caktohet me dakordësinë e personit nën mbikëqyrje bazuar në nivelin e tij arsimor dhe profesional.

Llojet e punës në interes publik do të jenë:

- a. Dhënia e ndihmave të ndryshme për personat, familjet apo grupet shoqërore në nevojë;

- b. Dhënia e ndihmës dhe e kujdesit për personat, familjet, fëmijët, të moshuarit, njerëzit me aftësi të kufizuar, etj.;
- c. Mirëmbajtja e pasurive kulturore dhe arkivore të kishës katolike siç mund të jenë godinat e kishave të vjetra, dioqezave, manastiret, bibliotekat, arkivat, muzet, galeritë, ikonat, statujat, mesharët, etj.;
- d. Mirëmbajtja e strukturave të “KISH”, të mensave, spitaleve si dhe të çdo organizate të lidhura me to;
- e. Mirëmbajtja e pasurisë ekologjike të kishave dhe enteve të saj si parqet, lulishtet, etj.;
- f. Asistimin e stafit të “KISH” në mensa;
- g. Çdo punë tjetër e cila konsiderohet e vlefshme për interesin publik dhe që synon riintegrimin social dhe rehabilitimin e të mbikëqyrurve.

Neni 4 Angazhimet e palëve

Palët angazhohen që të bashkëpunojnë në respektim dhe zbatim të kërkesave ligjore që burojnë nga ligjet dhe aktet e sipërcituara dhe në mënyrë të veçantë:

- a) Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion për çështje të veçanta për të cilat palët kanë interes të përbashkët, në respektim të ligjeve të posaçshme të sipërcituara;
- b) Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke akte ose literaturë juridike që kanë të bëjnë me zbatimin dhe mbikëqyrjen e dënimit alternativ “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik”;
- c) Të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta për përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga kjo marrëveshje;
- ç) Të organizojnë çdo formë tjetër të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve në funksion të përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje;
- d) Të bashkëpunojnë për shkëmbimin e praktikave më të mira në nivel kombëtar e ndërkombëtar në fushën ushtrimit të së drejtës së besimit e ndërgjegjes dhe riaftësimit e rintegritit të personave nën mbikëqyrje me dënimin alternativ “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik”;
- dh) Të bashkëpunojnë në mirëkuptim për numrin total të personave nën mbikëqyrje në mënyrë që mos të tejkalohen kapacitetet e tyre.

Neni 5 Roli dhe përgjegjësitë e Kishës Katolike

Roli dhe përgjegjësitë e Kishës Katolike janë si vijon:

- a) T’u ofrojë personave nën mbikëqyrje në rastet e dënimit alternativ sipas nenit 63 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik” mundësinë e kryerjes së punës nëpërmjet Kishës Katolike ose organizmave në varësi të saj, sipas nenit 3 të kësaj marrëveshje;
- b) Të mbajë takime ndërgjegjësuese mbi rolin e familjes, rëndësinë e tolerancës fetare, bashkëjetesës sociale, nxitjen e respektimit të ligjeve dhe rregullave, filma edukativ, etj.;

- c) T'u ofrojë personave nën mbikëqyrje sipas kërkesës së tyre, literaturë fetare, ndihmë shpirtërore, kremtimin e Meshës së Shenjtë, biseda mbi Ungjillin, doktrinën e Kishës Katolike, etj.;
- d) Të hartojë dhe t'i dorëzojë Shërbimit të Provës raportime periodike mbi aktivitetet e zhvilluara në zbatim të kësaj marrëveshje. Në këto raporte periodike nuk mund të përfshihen në asnjë rrethanë informacione dhe të dhëna konfidenciale ose sekrete të personave nën mbikëqyrje të asistuar, apo çfarëdolloj informacioni tjetër lidhur me ta, që e drejta kanonike e ndalon të bëhet publike nga meshtaret, dhe për të cilat stafi i angazhuar nga kisha katolike (meshtari dhe vullnetarët) janë vënë në dijeni gjatë asistencës që u kanë ofruar;
- e) Të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm i cili synon riintegrimin dhe rehabilitimin shoqëror të personit nën mbikëqyrje;
- f) Të vërë në dispozicion stafin e vetë dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e kushteve teknike të punës me qëllim mbrojtjen e shëndetit të personave nën mbikëqyrje.

Neni 6

Roli dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Provës

Roli dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Provës janë si vijon:

- a) Të njoftojë personat nën mbikëqyrje në rastet e dënimit alternativ "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik", për mundësinë e kryerjes së punës nëpërmjet Kishës Katolike dhe organizmave në varësi të saj;
- b) Të dërgojë personat nën mbikëqyrje, në rastet e dënimit alternativ "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik" për kryerjen e punës pranë "KISH" dhe organizmave nën varësinë e saj;
- c) Numri i personave që Shërbimi i Provës do të dërgojë për kryerjen e punës në interes publik do të jetë sipas mundësisë dhe pëlqimit të Kishës Katolike dhe të organizmave të saj;
- d) Shërbimi i Provës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do t'i dërgojë "KISH" dhe organizmave të saj, çdo të dhënë që do të konsiderohet e nevojshme për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të mbikëqyruar dhe që me pëlqimin e tyre dhe për ata që deklarohen se janë të besimit katolik "KISH" do të sigurojë asistencë shpirtërore dhe psiko-sociale.

Neni 7

Komunikimi dhe personat e kontaktit

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për realizimin e qëllimeve të kësaj marrëveshje. Shkëmbimi i informacionit mund të bëhet edhe në rrugë elektronike.
2. Për të rritur efikasitetin dhe në funksion të dinamikës së çështjeve, palët do të caktojnë personat e kontaktit që do të jenë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Në çastin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje personat e kontaktit janë si në Aneksin 1.
3. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në Aneksin 1, pala do të njoftojë me shkrim palën tjetër mbi të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 8
Ndryshimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me dakortësi të palëve, nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 9
Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje zbatohet për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga data e hyrjes së tij në fuqi, me mundësi rinovimi pas përfundimit të këtij afati dhe me konsensusin e palëve nënshkruese.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË PROVËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
(Në mungesë)

DREJTORI I MBIKËQYRJES
ELEKTRONIKE

ERIS SHESHI



PËR
KONFERENCËN IPESHKVORE TË
SHQIPËRISË

PRESIDENTI

GJERGJ META

Aneksi 1: Personat e Kontaktit.

Përfaqësues për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës:

Emër Mbiemër: Valbona Uku (Ndoçi)

Pozicioni: Specialist

Adresa: Rr. "Jorden Misja", pranë SPAK, Tiranë.

Tel: 068 303 0334

Email: valbona.ndoci@sherbimi.proves.gov.al

Përfaqësues për Konferencën Ileshkvore të Shqipërisë:

Emër Mbiemër: Valente Emilio

Pozicioni: Prof. i Bujqësisë, Res

Adresa: "Rr. Don Bosco", Tiranë.

Tel: 067 213 15 83

Email: emivale_2001@yahoo.it